

Nënskruhet Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë së Postave dhe Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Agjencia e Postave dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) më datë 17.10.2022, nënskruan Memorandum bashkëpunimi për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së konkurrencës në tregun e shërbimeve postare.

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të ketë për qëllim avancimin dhe ndihmën në zhvillimin e konkurrencës në tregun e shërbimeve postare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke u nisur nga rëndësia e këtij tregu për ekonominë e vendit, e veçanërisht nga përfitimet që dalin nga konkurrenca për përdoruesit përfundimtarë.

